



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 54

Tiranë – E hënë, 20 mars 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 17/2017, datë 9.3.2017	Për zgjatjen e afatit të Veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore..... 3309
Vendim i Kuvendit nr. 18/2017, datë 16.3.2017	Për kthimin e dosjeve të kandidatëve që kanë shprehur interesin për të kandiduar për institucionet e rivlerësimit tek Avokati i Popullit për riplotësim të dokumentacionit..... 3309
Vendim i Kuvendit nr. 19/2017, datë 16.3.2017	Për shkarkimin përpara afatit të zonjës Enkeleda Shehi nga detyra e anëtarit të bordit dhe drejtorit të përgjithshëm ekzekutiv të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare..... 3310
Vendim i Kuvendit nr. 20/2017, datë 16.3.2017	Për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare..... 3310
Rezolutë e Kuvendit datë 9.3.2017	Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Ujit (ERRU) për vitin 2016..... 3310
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 192, datë 15.3.2017	Për kalimin në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Punëve të Brendshme të pronës së paluajtshme shtetërore, ndodhur në zonën kadastrale 2573, indeks harte Ko-Mal-C-5 dhe numër pasurie 1-114, për pajisjen e subjektit “Partia Socialiste e Shqipërisë” me ndërtesë, për degën vendore të Partisë Socialiste Maliq..... 3313
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 193, datë 15.3.2017	Për një ndryshim në vendimin nr. 152, datë 29.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në pronësi, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit te Bashkia Korçë, të disa mjediseve të pronës me emërtimin “Shtëpia e Ushtarakëve”, me vendndodhje në bulevardin ‘Republika”, dhe për kalimin në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Punëve të Brendshme, të mjediseve të katit të parë teknik, të pronës me emërtimin “Shtëpia e Ushtarakëve” 3313



VENDIM
Nr. 17/2017

PËR ZGJATJEN E AFATIT TË
VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË
POSAÇËM PARLAMENTAR PËR
REFORMËN ZGJEDHORE

Në mbështetje të nenit 77, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të nenit 24, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Afati i veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore është 30 ditë nga data e miratimit të këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miruar në datën 9.3.2017

VENDIM
Nr. 18/2017

PËR KTHIMIN E DOSJEVE TË
KANDIDATËVE QË KANË SHPREHUR
INTERESIN PËR TË KANDIDUAR PËR
INSTITUCIONET E RIVLERËSIMIT TEK
AVOKATI I POPULLIT PËR
RIPLOTËSIM TË DOKUMENTACIONIT

Në mbështetje të nenit 78, të Kushtetutës, të neneve 71 dhe 113, të Kodit të Procedurave Administrative, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. T’i kthejë Avokatit të Popullit dosjet e depozituara të kandidatëve që kanë shprehur interesin për të kandiduar për institucionet e rivlerësimit. Avokati i Popullit, brenda 2 ditëve nga marrja në dorëzim e dosjeve të depozituara të

kandidatëve, që kanë shprehur interesin për të kandiduar për institucionet e rivlerësimit, njofton kandidatët që nuk kanë plotësuar kriteret formale për riplotësimin e dokumentacionit, kur kjo gjë është e mundur në kuadër të dokumentacionit të nevojshëm që vërteton përmbushjen e kriterëve ligjore. Kandidatët, brenda 7 ditëve nga dita e njoftimit prej Avokatit të Popullit, paraqesin dokumentacionin e nevojshëm për riplotësim të dokumentacionit përkatës pranë këtij institucioni, sipas neneve 6 dhe 7, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. I gjithë procesi zhvillohet nën monitorimin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

II. Avokati i Popullit, sipas pikës I, të këtij vendimi, për vlerësimin e kandidatëve, ndjek procedurat dhe afatet procedurale të përcaktuara në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

III. Kuvendi pezullon procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve, sipas ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, deri në ridërgimin e listave nga Avokati i Popullit, sipas këtij ligji.

IV. Vendimi i Kuvendit nr. 14/2017, “Për kthimin e dosjeve të kandidatëve që kanë shprehur interesin për të kandiduar për institucionet e rivlerësimit tek Avokati i Popullit për riplotësim të dokumentacionit dhe rihapjen e thirrjes për paraqitjen e shprehjes së interesit nga aplikantët të rinj për pozicionet e të gjithë anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit” shfuqizohet.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miruar në datën 16.3.2017



VENDIM
Nr. 19/2017

**PËR SHKARKIMIN PËRPARA AFATIT TË
ZONJËS ENKELEDA SHEHI NGA
DETYRA E ANËTARIT TË BORDIT DHE
DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM
EKZEKUTIV TË AUTORITETIT TË
MBIKËQYRJES FINANCIARE**

Në mbështetje të nenit 115, të Rregullores së Kuvendit, dhe të shkronjës “dh”, të paragrafit të parë, të nenit 8, të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të ndryshuar,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Shkarkimin përpara afatit të zonjës Enkelelda Shehi nga detyra e anëtarit të Bordit dhe Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 16.3.2017

VENDIM
Nr. 20/2017

**PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË
KËSHILLIT DREJTUES TË
AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

Në mbështetje të nenit 78, të Kushtetutës, të nenit 114, pika 3, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 61, pika 6, të ligjit nr. 102/2012, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë””, si dhe të nenit 111, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Alban Karapici zgjidhet anëtar i Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

II. Mandati i zotit Alban Karapici, si anëtar i Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, është 3-vjeçar.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 16.3.2017

REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË
ENTIT RREGULLATOR TË UJIT (ERRU)
PËR VITIN 2016**

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

- Duke njohur Entin Rregullator të Ujit si një institucion të pavarur publik, përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura në nivel kombëtar;

- Duke e konsideruar shumë të rëndësishme mbrojtjen e konsumatorit, në drejtëm të cilësisë më të mirë të shërbimeve të ofruara nga operatorët në sektor;

- Duke pasur parasysh që mungesa e furnizimit të vazhdueshëm dhe tendenca negative e këtij treguesi vijon të mbetet problem shqetësues, duke ndikuar edhe në cilësinë e ujit;

- Duke pasur parasysh që niveli i humbjeve në rrjet dhe i ujit pa të ardhura vijon të mbetet në nivele tepër të larta, duke sjellë si pasojë mosgjenerimin e të ardhurave;

- Duke njohur rolin e Entit Rregullator të Ujit në krijimin e një sektori ujësjellës - kanalizimesh financiarisht të qëndrueshëm, që ofron shërbime të një cilësie të lartë, por të përballueshme për të gjithë konsumatorët;

- Duke njohur sfidat e reja të këtij sektori, në kuadër të reformës administrative territoriale;

- Duke konsideruar si shumë të domosdoshme kryerjen e investimeve nga operatorët për përmirësimin e shërbimeve që ata ofrojnë dhe duke qenë të vetëdijshëm për ndikimin e këtyre inves-



timeve në rritjen e tarifave për këto shërbime;

Për vitin 2016 vlerëson:

- Përpjekjet e bëra nga ERRU-ja, në këtë moment tepër të rëndësishëm të riorganizimit të gjithë sektorit ujësjellës kanalizime, në zbatimin sa më të drejtë të politikave rregullatore, në kuadër të reformës për riorganizimin e operatorëve që veprojnë në sektorin ujësjellës-kanalizime.

- Kontributin e ERRU-së në hartimin e projektligjit për disa ndryshime në ligjin nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe bashkëpunimin e saj me Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës dhe institucionet e tjera pjesëmarrëse në këtë proces.

- Punën e bërë nga ERRU-ja në aspektin e rritjes së transparencës së shoqërive UK veçanërisht për sa i takon cilësisë së seancave dëgjimore me publikun, si edhe në paraqitjen e një analize të qartë të situatës, objektivave dhe planeve të veprimit për përmirësimin e gjendjes financiare të shoqërive e të rritjes së cilësisë së shërbimit, kur ato aplikojnë për tarifa të reja.

- Politikën vendimmarrëse të ERRU-së lidhur me përballeshmërinë e tarifave për shërbimet UK gjatë periudhës tranzitore të riorganizimit të sektorit.

- Punën e bërë nga ERRU-ja në monitorimin e shoqërive UK për të bërë të mundur vlerësimin real të punës së çdo shoqërie dhe vendosjen e objektivave konkretë dhe të arritshëm, duke pasur parasysh kapacitetet aktuale të shoqërive.

- Përmirësimin e performancës financiare të sektorit UK, gjë e cila shprehet me një rritje prej 18 për qind të kostove të mbulimit të shpenzimeve të O&M (Operim dhe Mirëmbajtje).

- Rritjen e eficiencës së stafit dhe uljen në mënyrë të konsiderueshme të shpenzimeve të shoqërive UK, të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në përmirësimin e gjendjes financiare të shoqërive.

- Rritjen e normës së arkëtimit, krahasuar me një vit më parë, rritje e cila, pavarësisht se është e vogël, vijon në tendencën pozitive të viteve të fundit.

- Punën e bërë nga ERRU-ja përmes instrumenteve si struktura tarifore, subvencion i kryqëzuar etj., për të bërë të mundur që tarifat e miratuara të jenë të përballeshme për konsumatorët.

Për vitin 2017 rekomandon:

- Të marrë masat e nevojshme për përbalimin në kohë dhe me cilësi të shqyrtimit të propozimeve nga shoqëritë UK për rishikimin e tarifave, në kuadër të zbatimit të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, si dhe të tregohet efikase dhe e kujdesshme në politikën e miratimit të tarifave, duke e parë atë të lidhur ngushtë me rritjen e performancës së operatorëve, uljes së shpenzimeve, rritjen e efikasitetit menaxhues dhe përmirësimin e shërbimit ndaj konsumatorit.

- Të marrë masat e nevojshme për licencimin, brenda vitit 2017, të të gjithë operatorëve UK që paraqiten pranë ERRU-së për licencim, në kuadër të përfundimit të procesit të riorganizimit të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime, në zbatim të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, si dhe monitorimin e kushteve të licencës.

- Të vijojë të nxisë të gjitha shoqëritë që të vazhdojnë me procesin e inventarizimit, në zbatim të ristrukturimit të sektorit UK, në kuadër të reformës territoriale, për të vijuar më tej me licencimin dhe miratimin e tarifave, në përmbushje dhe të kërkesave ligjore.

- Të vijojë përpjekjet në mbrojtje të konsumatorëve dhe zgjidhjes së ankesave të tyre, pavarësisht rolit ndërmjetës që ka me dispozitat në fuqi dhe vonesës së ndryshimeve të pritshme ligjore.

- Të thellojë bashkëpunimin me të gjithë aktorët për të bërë një vlerësim sa më real dhe objektiv të përballeshmërisë së tarifave dhe për të gjetur zgjidhjen më të mirë të mundshme për mbrojtjen e konsumatorëve me të ardhura të ulëta dhe njëkohësisht funksionimin e operatorëve në mënyrë të qëndrueshme.

- Të vijojë kontributin e saj për hartimin sa më parë të ligjit të ri, në përputhje me objektivat e Strategjisë Kombëtare të Furnizimit me ujë dhe kanalizime dhe direktivat e BE-së për institucionet e pavarura, ligj, i cili, ndër të tjera, synon rritjen e rolit të ERRU-së në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit, veçanërisht në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, si dhe rritjen e pavarësisë së institucionit të ERRU-së.

- Të marrë masat e nevojshme për implementimin e strukturës së re të ERRU-së, miratuar me vendim të Kuvendit nr. 34, datë 28.4.2016, duke e parë të lidhur ngushtë me rritjen e profesionalizmit dhe të pavarësisë operacionale të



rregullatorit, si dhe në përmbushje të sfidave që ERRU-ja ka përballë reformës territoriale.

- Përmes të gjitha instrumenteve ligjore që disponon, të kërkojë nga shoqëritë UK që të kenë përparësi të punës së tyre uljen e nivelit të humbjeve, i cili vijon të mbetet 67 për qind, nivel i cili është tepër i lartë dhe përbën një shqetësim kryesor për sektorin UK; evidentimi, eliminimi apo legalizimi i lidhjeve të paligjshme, me qëllim uljen e humbjeve në rrjet dhe uljen e ujit pa të ardhura, ndikojnë drejtpërdrejtë në qëndrueshmërinë financiare të shoqërive UK.

- Të vijojë nxitjen e shoqërive UK në instalimin e ujëmatësve të mëdhenj në të gjithë pikat kyçe të sistemeve të furnizimit me ujë, për të bërë të mundur hartimin e bilanceve të sakta të ujit, të cilat japin mundësinë e përcaktimit real të vlerës së Ujit Pa të Ardhura (humbjet administrative dhe teknike), si dhe përcaktimin e rrugëve dhe planeve të veprimit për zvogëlimin e tyre.

- Të vijojë nxitjen dhe monitorimin e vendosjes së matësve për konsumatorët nga shoqëritë UK, si një proces plotësisht i arritshëm nga shoqëritë UK, i cili do të ndikonte drejtpërdrejt në uljen e nivelit të lartë të faturimit aforfe për konsumatorët, si dhe në uljen e nivelit të shpërdorimit të ujit.

- Në kuadër të përmirësimit të cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve, përmes instrumenteve dhe strategjive rregulluese, të nxisë shoqëritë UK në rritjen e vazhdimësisë së shërbimit dhe cilësinë e ujit të pijshëm. Mungesa e furnizimit të vazhdueshëm dhe tendenca negative e këtij treguesi vijon të mbetet problem shqetësues, duke ndikuar edhe në cilësinë e ujit.

- Duke pasur parasysh që analiza e humbjeve, bazuar në “Bilancin e Ujit”, tregon që humbjet menaxheriale të ujit janë në nivele pothuajse të njëjta me ato teknike, nëpërmjet instrumenteve dhe strategjive rregulluese të kërkojë nga shoqëritë UK një menaxhim më të mirë të shërbimit të furnizimit me ujë.

- Të vendosë objektiva individuale për secilën nga shoqëritë ujësjellës - kanalizime, për të nxitur përmirësimin e mëtejshëm të eficiencës operationale dhe gjatë procesit të miratimit të tarifave të kërkojë nga shoqëritë argumentim të plotë mbi numrin e punonjësve dhe pozicionet e tyre të punës në strukturën organizative të shoqërisë.

- Të vijojë punën për monitorimin e rezultateve, nëpërmjet verifikimit të të dhënave, në veçanti të të dhënave që lidhen me treguesit kryesorë të performancës, pasi saktësia e të dhënave luan një rol të rëndësishëm në përcaktimin e tarifave.

- Të marrë masat e nevojshme dhe, në bashkëpunim me Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, të përgatisë aktet nënligjore, në mënyrë që shoqëritë UK të hartojnë planin e biznesit 5-vjeçar, si një instrument i domosdoshëm i aplikimit për tarifa të reja, dhe, në të njëjtën kohë, si një instrument vlerësimi nga ERRU-ja.

- Në bashkëpunim me AKUK-un (Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve) të krijojë një sistem digjital qendror raportimi, me të dhëna që raportohen *on line* nga shoqëritë e UK-së, dhe këto të dhëna të jenë disponibël në web.

- Të intensifikojë kontaktet me bashkitë, shoqëritë UK, si dhe bashkëpunimin me AKUK-un dhe gjithë aktorët në sektor për identifikimin e pengesave në realizimin e reformës në sektor, për të bërë të mundur kapërcimin e tyre dhe ecjen graduale drejt një sektori ujësjellës - kanalizimesh të pavarur financiarisht, që mbulon shpenzimet dhe ofron shërbime me cilësi të mirë dhe të përballueshme nga konsumatorët.

- Të jetë një pjesëmarrës aktiv dhe të japë kontribut konkret në përmirësimin e infrastrukturës ligjore në drejtim të përmbushjes së kushteve të Direktivës Europiane për Sektorin e Ujit.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 9.3.2017



VENDIM

Nr. 192, datë 15.3.2017

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË
PUNËVE TË BRENDSHME TË PRONËS
SË PALUAJTSHME SHTETËRORE,
NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE
2573, INDEKS HARTE KO-MAL-C-5 DHE
NUMËR PASURIE 1-114, PËR PAJISJEN E
SUBJEKTIT “PARTIA SOCIALISTE E
SHQIPËRISË” ME NDËRTESE, PËR
DEGËN VENDORE TË PARTISË
SOCIALISTE MALIQ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8, pika 3, 10, 13 e 14, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 22, shkronja “b” e 22/1, të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000, “Për partitë politike”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Punëve të Brendshme të pronës së paluajtshme shtetërore ndodhur në zonën kadastrale 2573, indeks harte Ko-Mal-C-5 dhe numër pasurie 1-114, me qëllim pajisjen e subjektit “Partia Socialiste e Shqipërisë” me ndërtesë, për degën vendore të Partisë Socialiste Maliq.

2. Ministri i Punëve të Brendshme të lidhë kontratën e huapërdorjes, sipas Kodit Civil, me subjektin “Partia Socialiste e Shqipërisë”, në përputhje me shkronjën “b”, të nenit 22, të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000, të ndryshuar, për periudhën derisa partia politike plotëson kushtet e parashikuara në këtë nen.

3. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 193, datë 15.3.2017

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 152, DATË 29.2.2016, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR KALIMIN NË
PRONËSI, NGA MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT TE BASHKIA KORÇË, TË
DISA MJEDISEVE TË PRONËS ME
EMËRTIMIN “SHTËPIA E
USHTARAKËVE”, ME VENDNDODHJE
NË BULEVARDIN ‘REPUBLIKA’”, DHE
PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË
PUNËVE TË BRENDSHME, TË
MJEDISEVE TË KATIT TË PARË
TEKNIK, TË PRONËS ME EMËRTIMIN
“SHTËPIA E USHTARAKËVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10, 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “a”, të nenit 8/a, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Revokimin e së drejtës së pronësisë për Bashkinë Korçë, të mjediseve të katit të parë teknik, të pronës me emërtimin “Shtëpia e Ushtarakëve”, me sipërfaqe ndërtimi 348 (treqind e dyzet e tetë) m², dhe heqjen e këtyre mjediseve nga formulari që i bashkëlidhet vendimit nr. 152, datë 29.2.2016, të Këshillit të Ministrave.

2. Mjediset e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, kalojnë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

3. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, Bashkia Korçë dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 042427006

Çmimi 56 lekë